

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE-DEGA PODUJEVE, Departamenti i përgjithshëm**, si gjykatë civile e shkallës së parë e përbërë nga gjyqtari Binak Duqi me sekretaren juridike Xhevide Selmani, ne çështjen juridike të paditësve N.H., A.H., M.A., R.H. dhe N. H. nga fshati B. Komuna e P., të cilit i përfaqëson Xh. K. avokat nga P. me autorizim, kundër të paditurës KS “S.” nga Prishtina, të cilën e përfaqëson F.Q. me autorizim, për kompensim dëmi, në shqyrtimin kryesor, publik, të mbajtur në prani të paditësit N.H. dhe të autorizuarit të tij dhe si i autorizuar i paditësve tjerë dhe përfaqësueses së të paditurës me dt. 07.11.20123, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**I. PJESERISHTE aprovohet** kërkesëpadia e paditësve: N.H., A. H., M. A., R. H. dhe N. H. nga fshati B. Komuna e P., si e **BAZUAR**.

**II. DETYROHET** e paditura KS “S.” nga Prishtina, që paditësve në emër të dhimbjeve shpirtërore për vdekjen e nënës- fëmijëve të sajë tua kompensoi dhe atë:

**Paditësve** N.H., A. H., M. A., R. H. dhe N. H. nga fshati B. Komuna e P..

Për secilin prej tyre nga 5000 € (pesëmijë) €.

Gjithsejtë shuma e aprovuar e paditësve për kompensim të dëmit jo material në emër të dhembjeve shpirtërore është shuma prej 25.000 € (njëzetepesëmijë) €.

Përtej shumës së aprovuar shuma prej 35.000 €, refuzohet si e pa bazuar.

- Në emër të dëmit material për shpenzimet e varrimit paditësve iu aprovua shuma prej 1500 €.

Në emër të ngritjes së përmendores u aprovua shuma prej 1500 €.

Gjithsejtë shuma e aprovuar për kompensim të dëmit jo material dhe material për paditësit është shuma prej 28.000 €.

Përtej shumës së aprovuar për kompensim shuma prej 37.000 € refuzohet si e pa bazuar.

**Detyrohet** e paditura KS “S.” nga P. që shumën prej 28.000 €, paditësve tu a paguaj me kamatë si që e paguajnë bankat afariste të Kosovës për mjete të deponuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 07.11.2013, e gjer në pagesën përfundimtare në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykim, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

**Detyrohet** e paditura KS “S.” nga Prishtina që paditësve tua paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 750 € në afat prej 15 ditësh, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

## **A r s y e t i m**

Paditësit në padi dhe precizim të kërkesëpadisë fjalë përfundimtare gjatë seancës kryesore nëpërmes të autorizuarit të tyre Xh. K. avokat nga P., kanë deklaruar se me dt. 08.05.2011, rreth orës 13,55 h, në fshatin Peran, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit në mes të automjetit A, Audi 89 me targa *numër i targave...* dhe automjeti VW Ij Golf me targa *numër i targave....* deri te aksidenti ka ardhur kur vozitësi i veturës audi 89 merr veprim për të u qyqur nga rruga kryesore duke i dalur në rrugë automjetit golf me që rast shkaktohet aksidenti i trafikut dhe nga lëndimet e marra më vonë ndërron jetë pasagjerja Z. H..

Nga vdekja e nënës së tyre paditësit kanë përjetuar dhimbje të madhe shpirtërore shpenzimet për varrim dhe ngritje të përmendores sipas adeteve tona.

I autorizuari i paditësve më tutje ka deklaruar se paditësit kërkojnë kompensim dëmi në cilësinë e palëve të treta edhe pse shkaktar i aksidentit ka qenë pa patentë shofer kjo nuk ndikon sepse sipas ligjit mbi sigurimet e detyrueshme nga auto përgjegjësia për palët e treta neni 114 .2 i ligjit kështu e thotë. “Meqenëse baza juridike nuk është kontestuese nga provat në shkresat e lëndës atëherë ai ka bërë

precizimin e kërkesëpadisë duke kërkuar nga 12.000 € për dhimbje shpirtërore për vdekjen e nënës, për secilin paditës shpenzime të varrimit 3000 € dhe për ngritjen e përmendores 2000 €.

Andaj i propozoi gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta miratoi në tërësi si të bazuar me kamatën 12% sipas nenit 6 të ligjit mbi sigurimet e detyrueshme nga auto përgjegjësia. Shpenzimet i kërkoi sipas TA.

Përfaqësuesi i të paditurës në të përgjigjur në padi gjatë seancës dhe fjalë përfundimtare ka deklaruar se e kontestojmë bazën juridike në tërësi të kërkesëpadisë si dhe lartësinë e saj të bërë në precizimin e dt. 07.11.2013. duke shtuar më tutje se meqenëse shkaktari i aksidentit ka qenë pa patentë shoferë V. H. e që kjo ceket edhe në raport të policisë atëherë paditësit e kanë humbur mbulesën siguroese dhe nuk ekziston detyrimi për kompensim dëmi nga e paditura por ky është detyrim i vetë shkaktarit të aksidentit. Andaj konformë kushteve të standardit minimal për policë të sigurimit ka humbur mbulesën siguroese dhe në këtë rast e paditura do të ishte ndërmjetësuese në qoftëse në mesë shkaktarit që ka humbur mbulesën siguroese dhe paditësve nuk do të kishte afërsi familjare mirëpo në këtë rast ai është bashkëshorti i të ndjerës.

I ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoi në tërësi si të pabazuar.

Shpenzimet e procedurës i kërkoi .

Gjykata për të vlerësuar drejtë gjendjen faktike në këtë çështje juridike kontestimore në procedurën e provës bëri administrimin dhe leximin e këtyre provave:

U lexua fletlëshimi nga QKUK Prishtinë klinika e ortopedisë me nr. Të amzës 723 që është gabimisht është shenuar emri i bashkëshortit të sajë V.H. e që duhet të jetë Z. (M.) H. e lindur me *viti i lindjes...*, si që është cekur edhe në raportin e hetuesit me nr.Rasti 2011-AR-0463, dt. 08.05.2011, u lexua deklarata e bashkësisë familjare nr. 2689 lëshuar nga zyra e gjendjes civile Podujevë, dt. 06.02.2013, përgjigja në padi e të paditurës , certifikata e vdekjes për Z. H.-J. me nr. Z....., lëshuar nga zyra e gjendjes civile Podujevë me dt. 15.06.2011, certifikata e lindjes për A. H. me nr. Rendor 0..., nr. Reference ..., lëshuar nga zyra e gjendjes civile Podujevë me dt. 17.06.2011, certifikata e lindjes për N. H. me nr. Rendor .. ner. Reference .. , lëshuar nga zyra e gjendjes civile Podujevë dt. 21.06.2011, certifikata e lindjes për M. H. nr. Rendor .., nr. reference ..., lëshuar nga zyra e gjendjes civile Podujevë me dt. 17.06.2011, certifikata e lindjes për N. H. me nr. Rendor .. nr. Reference ..., lëshuar nga zyra e gjendjes civile Podujevë me dt. 17.06.2011, certifikata e lindjes për R. H. me nr. Rendor .. nr. Reference .. lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Podujevë me dt. 16.03.2009, raporti hetuesit me nr. Rasti 2011-AR-0463, si dhe shkresat tjera të lëndës.

Pa vërejtje nga palët ndërgjyqëse.

Gjykata pasi i vlerësoi një nga një provat dhe të gjitha së bashku konformë nenit 8 të LPK, erdhi në përfundim të kësaj gjen dje faktike: se kërkesëpadia e paditëseve është pjesërisht e bazuar dhe si të tillë e aprovoi.

Është jo kontestuese se me dt. 08.05.2011, ka ndodhur aksident komuniackioni në fshatin Peranë në mes automjetit A, Audi 89 me targa *numër i targave...*, ngjyrë të kuqe i siguruar te KS “S., dhe automjeti nën B, volcvagen 1 J golf TDI ngjyrë hiri metalike me targa të regjistrimit *numër i targave...*, e që vozitës ishte I. H. E..

Është jo kontestuese se në automjetin A, Aujdi 89 në cilësi të bashkë udhëtar ishte dhe Z.( M.) H., e lindur me dt. *data e lindjes...* nga P. Komuna e P., bashkëshortja e vozitësit të automjetit A, V. (A.) H., i lindur me *data e lindjes...* në P.. Është po ashtu jo kontestuese se automjeti A, audi 89 me targa të regjistrimit *numër i targave...*, ishte e siguruar te e paditura me policë sigurimi 0002809050 me vlefshmëri deri me 16.03.2012.

Po ashtu është jo kontestuese se në këtë aksident pas lëndimeve të marra si bashkudhëtar në automjetin A, ka vdekur Z. M. H. nëna e paditësve.

E tëra kjo vërtetohet pa dyshim nga raporti i hetuesit me nr. Rasti 2011-AR-0463 dt. 08.05.2011, certifikata e vdekjes për të ndjerën Z. H.- J. me nr. Rendor .. dhe nr. Reference .. lëshuar nga zyra e gjendjes civile Podujevë me dt. 15.06.2011, policia e sigurimit për automjetet lëshuar nga e paditura KS "S." me nr. 0002809050 me vlefshmëri gjerë me 16.03.2012, deklarata mbi bashkësinë familjare me nr. Rendor .... e lëshuar nga zyra e gjendjes civile Podujevë me 06.02.2013, si dhe certifikatat e lindjes për të gjithë paditësit.

Kontestuese ishte se a kanë të drejtë kompensimi paditësit me rastin e vdekjes së nënës së tyre në aksident pasi që ka marrë paraprakisht lëndime trupore. Gjykata duke u nisur nga rregulli 3 i BQK, ligji mbi sigurimet e detyrueshme nga auto përgjegjësia për dëmet e shkaktuar a palëve të treta, LMD, automjeti i siguruar te e paditura ne policë sigurimi që kishte validitet në kohën e aksidentit, kriteret e kompanive të sigurimeve të miratuara nga to dhe nga vetë e paditura dhe praktika gjyqësore gjeti se ka bazë juridike për të u kompensuar paditësit për humbjen e nënës së tyre si anëtarë i ngushtë i familjes për dhimbje shpirtërore të përjetuara të paditësve pas vdekjes së sajë në aksident.

Pavarësisht asaj se ngasësi i veturës të automjetit A, Audi 89 për ndryshe bashkëshorti i të ndjerës dhe babai i paditësve i cili në atë moment ishte pa patentë shofer kjo nuk ndikon në kompensimin e dëmit jo material për persona të tretë në rastin konkret nëna e paditësve ishte pasagjere në automjetet dhe atyre u takon e drejta e kompensimit për dhimbje shpirtërore me rastin vdekjes së nënës së tyre.

Me gjithë kundërshtimet e të paditurës se paditësit nuk kanë të drejtë kompensimi gjykata nuk e pranoi një kundërshtim të tillë dhe e vlerësoi si të pabazuar thëniet e përfaqësueses së sajë e cila ka deklaruar se ngasësi ka qenë pa patentë shofer e humbë mbulesën siguroese. Kjo nuk qëndron në asnjë rrethanë dhe paditësit e kanë të drejtën e kompensimit e këtë ja u sigurojmë provat e lartpërmendura më sipër. Se paditësit N. H., A. H., M.A., N. H. dhe R. H., janë fëmijët- djemtë dhe vajza e të ndjerës Z.H.- dhe vozitësit V. H. kjo vërtetohet nga certifikatat e lindjes që gjenden në shkresat e lëndës të cilat u administruan në procedurën e provës së dhe nga deklarata mbi bashkësinë familjare me nr. Rendor .... dt. 06.02.2013, lëshuar nga zyra e gjendjes civile Podujevë.

Është e vërtetë se në certifikatë të lindjes dhe atë të vdekjes sa i përket emrit të ndjerës Zyhra nënës së paditësve ka dallime ku në disa prej tyre shkruan Zyhra në një tjetër Zyhri e dikun Zymri por kjo mund të jetë gabim gjatë regjistrimit të paditësve në ofiqarin përkatëse kompetente të komunës së Podujevës e nuk është gabim i paditësve mirëpo prapë se prapë është e besuar se fjala është për të njëjtin person pra nëna e paditësve.

Sa i përket lartësisë së kompensimit të dëmit jo material për paditësit me rastin e humbjes së nënës së tyre në aksident gjykata i pati parasysh kriteret e kompanive të sigurimeve të miratuara nga vetë e paditura pjesërisht e të cilat janë që nga viti 2001 të aprovuara e të pa ndryshuara dhe jo obligative për gjykatën, LMD, praktikë gjyqësore moshën e të ndjerës, lidhjet emocionale të paditësve në prindërit e tyre e të cilat dhembje konsiderohen të mëdha pa dyshim dhe janë të pa llogaritshme e nuk mund të eliminohen me kurrfarë shpërblimi me para.

Gjykata i pati parasysh edhe kundërshtimet e të paditurës e cila i kundërshton shumat e kërkuara të bëra nga pala paditëse në precizimin e sajë e cila kërkon për secilin paditës nga 12.000 € prandaj gjykata kërkesën e tillë e cilësoi si e lartë andaj gjykata duke pas parasysh kundërshtimi në të paditurës dhe kriteret pjesërisht si dhe LMD praktikën gjyqësore ju aprovoi secilit paditës për dhimbje shpirtërore për vdekjen e nënës së tyre nga 5000 € duke menduar se është satisfakcioni më real për rastin konkret dhe se shumat e aprovuara sadopak ju kompensojnë dhembjen pasi që e ndjera nëna e paditësve ishte në moshë të shtyrë 76 vjeçare.

Gjykata pati parasysh po ashtu parimin që shumat e aprovuara të mos u shkojë përshtati synimeve për pasurimin e njëjës palë dhe dëmtimin e palës tjetër poqë shumat e aprovuara për kompensim të jenë në pajtim me natyrën e sajë dhe qëllimin shoqërorë si që e parasheh edhe neni 200 al.1. dhe 2 i LMD.

Sa i përket kompensimit të dëmit material për shpenzimet e varrimit si që e parasheh neni 193 al.1. i LMD, gjykata e aprovoi shumën prej 1500 € kurse e refuzoi shumën prej 1500 € si kërkesë e lartë.

Gjykata me këtë rast pati parasysh adetet tona dhe rrethit ku jetojnë paditësit duke mendua se shuma e aprovuar është satisfakcioni real për paditësit.

Gjithashtu gjykata paditësve ju aprovoi shumën prej 1500 € në emër të kompensimit të dëmit material për ngritjen e përmendores së nënës së tyre po ashtu duke u bazuar në adetet tona dhe rrethin ku jetojnë paditësit. Duke mendua se me shumën e aprovuar paditësit mund të ngrisin një përmendore mesatare nënës së tyre dhe duke pas parasysh se ata ndoshta nuk kanë mjete më përpara të ngrisin përmendoren për ta siguruar provën se sa ju ka kushtuar ajo e që këtë nuk e kërkon as e paditura por nuk kërkohet as me kriteret e kompanive të sigurimeve dhe nuk është e paraparë. Kurse me sigurimin e provave për shpenzimet e krijuara për varrimin dhe të pamën e sajë gjykata është e mendimit se familjarët e sajë as që ju bie në ndërmend të sigurojnë prova të tilla atyre me rastin e humbjes së më të dashurës së tyre nënës.

Gjykata gjithashtu gjatë tërë kohës pati parasysh kundërshtimet e të paditurës por sa i përket bazës juridike ato i vlerëso si të pa bazuara kurse sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë së precizuar ato pjesërisht i pati parasysh dhe i pranoi si të bazuara.

Për lartësinë e aprovuar gjykata pati parasysh nenin 200 të LMD lidhur me nenin 232 të LPK.

Pjesa refuzuese nga gjykata e shumave të kërkuara për kompensim nga pala paditëse si që është e cekur në dispozitiv të aktgjykimit është sepse pala paditëse nuk e argumentoi me asnjë provë bazueshmërinë e pjesës së refuzuar si që e parasheh neni 3 i LPK, ku thuhet se pala paditëse ka për detyrë ti paraqes faktet mbi të cilat i mbështetë kërkesat e veta dhe të propozoi prova me të cilat konstatohen ato fakte.

Gjykata është e mendimit se shumata e aprovuara gjithashtu janë kompensimi më real me të mirën e shkelur dhe qëllimin që u shërben ky kompensim.

Meqenëse e paditura ka rënë me vonesë për kompensimin e dëmit paditësve sipas nenit 277 të LMD, gjykata e detyroi të paditurën që paditësve shumën e gjykuar të ju paguaj me kamatë si që e paguan bankat afariste në Kosovë për mjete të deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar kurse e refuzoi kërkesën për kamatën prej 12% të palës paditëse si të pa bazuar.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore u muarr konformë neneve 449, 452. 2, 2453 të LPK, duke pas parasysh suksesin e palës paditëse në kontest që ishte i pjesshëm dhe pjesërisht ju pranuan shpenzimet në këtë rast e që kanë të bëjnë me 300 € për një përfaqësim 150 € për padi si dhe 300 € për taksë gjyqësore prej tyre 150 € taksë për padi dhe 150 € taksë për aktgjykim .

E që gjithsejtë shuma e aprovuar e shpenzimeve është 750 €, kurse shuma tjetër prej 205 € ju refuzua si e pabazuar.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE- DEGA PODUJEVE**

**C.nr.298/11 të dt.07.11.2013**

**Gjyqtari:**  
Binak Duqi

**KESHILLA JURIDIKE;**

Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar  
Ankesa në afatin prej 15 ditësh, prej ditës  
së marrjes së këtij Gjykatës së Apelit  
Prishtinë përmes kësaj gjykate.